



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

VENDIM

Nr. 59, datë 30.01.2020

**PËR
MIRATIMIN E PJESËMARRJES SË GJYQTARËVE NË TRAJNIMIN VAZHDUES
PRANË SHKOLLËS SË MAGJISTRATURËS PËR PERIUdhËN
JANAR – MARS 2020**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, në mbështetje të neneve 61, 68, nenit 88 shkronja “a” dhe “c” dhe nenit 272, pika 3, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, si edhe të nenit 5, pika 3 dhe 6, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, me propozim të Komisionit të Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale, bazuar në kërkesat e përcjella nga Shkolla e Magjistraturës,

V E N D O S I :

1. Të miratojë kërkesat e gjyqtarëve për të marrë pjesë në programin e formimit vazhdues pranë Shkollës së Magjistraturës, për periudhën janar-mars 2020, sipas listës së pjesëmarrësve për çdo aktivitet trajnimi, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij vendimi.
2. Gjyqtarët e miratuar sipas pikës 1 të këtij vendimi, marrin pjesë në aktivitetet trajnuese, sipas rregullave të parashikuara në Rregulloren e Brendshme të Shkollës së Magjistraturës.
3. Gjyqtarët duhet të marrin masa organizative për të mos penguar ushtrimin e veprimtarisë gjyqësore ose asaj për të cilën janë komanduar, gjatë kohëzgjatjes së aktivitetit trajnues.
4. Ky vendim i njoftohet Shkollës së Magjistraturës, gjykatave dhe institucioneve të tjera ku gjyqtarët pjesëmarrës në trajnim ushtrojnë detyra të tjera si gjyqtarë të komanduar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë me botimin e tij në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR